

REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KOMBODRE KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY		REPUBLIC OF KOSOVO	
Dep.	Dep. DPK/DMP	Nr. Prot.	
Dep.		Prot. No.	03-2952/12
Nr. I. Os.		Data	22.08.2012
Brigj. Nr. Os.	02		
Re.l.nr.643/2012			

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Blerim Piraj nga fshati Pllavë komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1 dhe 3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 14.08.2012, merrë këtë

A K T V E N D I M

I PANDEHURI Blerim Jonuz Piraj nga fshati Pllavë komuna e Dragashit, Shqiptar, Shtetasë i Republikës së Kosovës, punëtor, me banim të përherëshëm në vendlindje.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Për arsye se si zyrtar i lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31.mars të vitit 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formullarin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit.

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1/3 të Ligjit nr.04/L-050. e në bazë të kësaj dispozite e konform nenit 10 të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe i pandehuri,

DENOHET

ME QORTIM.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmesë kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë. 01-2224/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Blerim Piraj me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

I pandehuri Blerim Piraj në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësiaht për mes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formullarin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Ka deklaruar se me tëu njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me dt. 02.08. 2012 e ka paraqit formullarin dhe njëherit e ka bër deklarimin e pasurisë. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes dhe marrëjes së aktvendimit të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejn si rrethana letësuese.

03-2952/12/02
Sung


Gjykata ka lexuar shkresat se rendes te Agjencionit kundër korrupsionit, deklaraten e të pandehurit, deshmit e prezentuara dhe pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se i pandehuri Blerim Piraj si zyrtar publik i obliguar për ta deklaruar pasurin, në afatin e përcaktuar ligjor si në dispozitiv nuk e ka plotësuar dhe nuk i ka derguar formularin Agjencionit më së voni deri më dt.31.03.2012.

Me këto veprime ka kryer kundërvajtje të sanksionuar me nenin 17 pika 1 dhe 3 të Ligjit nr/04/L-050

Gjykata ndaj të pandehurit konform nenit 10 të LMK-së e ka bër zbutjen e denimit nga rrethanat, se i pandehuri për herë të parë ka kryer kundërvajtje të kësaj natyre, se nuk ka qenë i informuar mirë me Ligjin nr. 04/L-050 dhe obligimet sipas këtij Ligji, se me të njoftuar me obligimin Ligjor me dt.15.06.2012 përmes formularit e ka bër deklarimin e pasuris.

Me sa u tha me lartë është vendosur si më sipër të keti aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË
DRAGASH, Me datën 14.08.2012, Re.



Gjyqtari për kundërvajtje,
Bekri Vehapi

KËSHILLA JURIDIKE; kundër këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejten e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenplar pa taksa përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.